

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, e përbërë nga gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti, me sekretaren juridike Fatmire Podvorica, në çështjen penale kundër të pandehurit G.I. F. nga fshati S., Komuna e P., për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 të KPK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike Komunale tani Prokuroria Themelore në Prishtinë PP.nr.4529-5/2011 të dt.29.02.2012, në seancën e shqyrtimit gjyqësor fillestar, të mbajtur në prezencën e Prokurorit të shtetit Enver Krasniqi nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, të pandehurit G. F. dhe të dëmtuarës E. F., pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor fillestar të mbajtur më dt.06.01.2015, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurit: **G. F.**, nga i ati I. dhe e ëma Sh., e vajzërisë G., i lindur më dt.data e lindjes... në fshatin S., Komuna e P., ku edhe tani jeton, nr. personal *numër personal...*, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomiko sociale, shfrytëzues i Pensionit me Aftësi të Kufizuara, Shqiptarë, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPPRK-së.

REFUZOHET AKUZA

Sepse :

Me qëllim me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, me dt.03.08.2011, rreth orës 20:00, në fshatin S., Komuna e P., me përdorimin e forcës me mjet të fortë, të pidentifikuar deri më tani, ka thyer derën e shtëpisë së njerkes së tij, ka depërtuar brenda, dhe nga aty ka marrë: një shporet elektrik në vlerë prej 100€, një qese me kafe dhe disa supa në vlerë prej 20€, dhe menjëherë është larguar nga vendi i ngjarjes, me ç'rast të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 120€,-

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 të KPK-së.

Për shkak se Prokurori i shtetit Enver Krasniqi nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, në mungesë të propozimit për ndjekje është tërhequr nga akuza në shqyrtimin gjyqësorë.

- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Publike Komunale tani Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën PP.nr.4529-5/2011 të dt.29.02.2012, ka akuzuar të pandehurin G. I. F. nga fshati S., Komuna e P., për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 të KPK-së.

Në shqyrtimin gjyqësor fillestar të mbajtur më dt.06.01.2015, sipas ftese gjykatës iu paraqitën Prokurori i Shtetit Enver Krasniqi nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, i pandehuri G. F. dhe e dëmtuara E. F..

E dëmtuara E. F. në seancën e shqyrtimit gjyqësor fillestar, para se Prokurori i shtetit ta lexoi aktakuzën, kërkoi fjalën para gjykatës dhe me këtë rast deklaroi se e tërhiqem nga propozimi për ndjekjen penale ndaj vëllait tim të pandehurit G. F., pasi që nga ajo kohë më nuk kemi pasur asnjë problem, tërheqjen e propozimit për ndjekje e bëj pa kurrfarë presioni, me vullnetin tim të plotë.

Prokurori i Shtetit Enver Krasniqi nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, në shqyrtim gjyqësor fillestar lidhur me deklarinimin e të dëmtuarës E. F. për tërheqje nga propozimi për ndjekje penale ka deklaruar: meqenëse e dëmtuara E. F. përkatësisht motra e të pandehurit G. F. gjatë kësaj seance është tërhequr nga propozimi për ndjekje penale, duke u bazuar nën nenin 275 të KPK-së, Prokurori i shtetit konform nenit 52 të KPPRK-së, tërhiqet nga ndjekja e më tutjetshme penale nda G. F., meqenëse vepra penale për të cilën është akuzuar, ndiqet sipas propozimit të palës së dëmtuar e cila në këtë rast është në marrëdhënie familjare me të akuzuarin.

Meqenëse për veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 të KPK-së, procedura penale fillon sipas propozimit të palës së dëmtuar kur vepra penale kryhet kundër personit me të cilin kryerësi ka lidhje familjare, pas tërheqjes së propozimit nga ana e të dëmtuarës gjatë shqyrtimit gjyqësor fillestar dhe tërheqjes së Prokurorit të Shtetit nga aktakuza ndaj të pandehurit, gjykata në bazë të nenit 363 par.1 nën par.1.1 të KPPRK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale mbështetet në nenin 454 par.1 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË- DEGA PODUJEVË
Pka.nr.66/2012 më dt.06.01.2015

Gjyqtari :
Minir Hoti

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit. Ankesa bëhet nëpërmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.